

Partia “GUXO”

Statuti

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Emri

Subjekti politik mban emrin “GUXO” dhe akronimin zyrtar GUXO.

Neni 2

Vlerat themelore

Guxo është parti politike, në vlerat fundamentale të së cilës ngërthen:

1. Lirinë, barazinë dhe demokracinë;
2. Ndërtimin e shtetit demokratik dhe të së drejtës, që garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, dinjitetin njerëzor
3. Humanizmin dhe frymën e tolerancës e të bashkëjetesës kombëtare, etnike, gjinore e fetare;
4. Vlerat dhe parimet evropiane dhe aspiratën për integrimin euroatlantik të Republikës së Kosovës.

Neni 3

Selia e GUXO

1. GUXO e ka selinë qendrore të saj në kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinë.
2. GUXO themelon degët e saj edhe në qytete dhe komuna të tjera.
3. GUXO ushtron veprimtarinë e saj edhe jashtë Republikës së Kosovës, në përputhje me ligjet e vendeve përkatëse.

Neni 4

Simbolet e GUXO

1. Simbolet e GUXO janë: Stema, flamuri dhe vula e GUXO, të bashkëngjitura në shtojcën I të këtij Statuti.
2. Stema e GUXO përdoret në të gjitha dokumentet dhe komunikimin zyrtar të organeve të subjektit.

3. Vula përdoret në emër të organeve qendrore të GUXO dhe administratës së selisë qendrore. Degët e GUXO, përveç vulës, në komunikimin e tyre shtojnë edhe emrin përkatës të degës.
4. Flamuri i GUXO përdoret në të gjitha ambientet dhe aktivitetet e subjektit.

KAPITULLI II

ANËTARËSIA

Neni 5

Kushtet dhe kriteret për anëtarësim

1. Anëtar i subjektit mund të jetë çdo qytetar, i cili ka të drejtë vote dhe që pranon kushtet e anëtarësimit dhe përkrah vlerat themelore të GUXO;
2. Anëtarësimi bëhet me vullnet të lirë dhe në formë të shkruar në nëndegë dhe degë.
3. Konsiderohen anëtarë të GUXO, me të drejtë vote, të gjithë ata që:
 - 3.1 Kanë mbushur moshën 16-vjeç;
 - 3.2 Marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve ku bëjnë pjesë;
4. Interesimet për anëtarësim duhet të paraqiten me shkrim duke plotësuar formularin përkatës:
 - 4.1 Në nëndegën e GUXO;
 - 4.2 në degën në qytetin përkatës;
 - 4.3 në Selinë Qendrore
5. Pranimi në nëndegë apo degë bëhet vetëm për anëtarët që banojnë në territorin përkatës dhe konfirmimi për pranim bëhet nga dega.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve

1. Anëtari i GUXO ka të drejtë:
 - 1.1 të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet e GUXO-së;
 - 1.2 të marrë pjesë në aktivitetet, mbledhjet, zgjedhjet sipas Statutit në çdo veprimtari të GUXO-së;
 - 1.3 të shprehë lirisht mendimin e tij dhe të respektohet dinjiteti dhe integriteti i tij për mendimin e dhënë;
 - 1.4 të japë propozimet e tij për të gjitha organet legjislative e ekzekutive të GUXO, duke iu përmbajtur Statutit dhe qëndrimeve themelore politike të tij si dhe mund t'iu drejtohet për çështjet vetjake e të GUXO të gjitha organeve drejtuese të saj.
3. Anëtari i GUXO ka detyrë dhe përgjegjësi:
 - 3.1 Në çdo aktivitet që përfaqëson anëtarin e GUXO, në frymën demokratike të përfaqësuesve me dinjitet duke ruajtur nderin dhe autoritetin e subjektit;

Neni 7

Përfundimi i anëtarësisë

Anëtarësia përfundon:

1. Me dorëheqje;
2. me përjashtim.

KAPITULLI III

FUNKSIONIMI I SUBJEKTIT

Neni 8

Zgjedhjet e brendshme

1. Të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur e gëzon secili anëtar që përmbush kushtet e parashikuara me legjislacionin në fuqi dhe me këtë statut.
2. Vota e çdo anëtari është e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.
3. Organizimi i brendshëm i subjektit bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, dhe periodike. Mandati i organeve në GUXO është 4-vjecar.
4. Sistemi zgjedhor brenda subjektit garanton parimin e konkurrencës së lirë dhe shanseve të barabarta midis kandidatëve, sipas kriterëve të shpallura dhe të njohura paraprakisht.
5. Kandidatëve për çdo organ të subjektit u garantohet e drejta e barabartë në procesin zgjedhor dhe kontrollin mbi mënyrën e realizimit të tij.

Neni 9

Shumica e kërkuar për vendimmarrje

1. Vendimet quhen të miratuara nëse votat “pro” përbëjnë mbi 50% të votave të vlefshme të pjesëmarrësve në votim, me përjashtim të rasteve kur në Statut parashikohet ndryshe. Kur votat janë të barabarta propozimi i votuar konsiderohet i pa miratuar. Abstenimet merren në konsideratë për llogaritjen e kuorumit.
2. Për ndryshime statutare nevojitet shumica e kualifikuar (2/3) e anëtarëve të Kuvendit të Përgjithshëm me të drejtë vote.
3. Propozimet për ndryshimet statutare mund ti bëj:
 - 3.1 Kryesia e Partisë
 - 3.2 50% e anëtarëve të Këshillit të përgjithshëm dhe
 - 3.3 ¼ e anëtarëve të Kuvendit të Përgjithshëm.

Neni 10

Llojet e votimit

1. Votimi rreth temave është i hapur nëse nga së nga së 25% e anëtarëve me të drejtë vote nuk kërkohet që votimi të jetë i fshehtë.

2. Votimi rreth zgjedhjes së personave është gjithmonë dhe në të gjitha nivelet e organizimit i fshehtë
3. Votimi është i fshehtë edhe në rastet e veçanta, të parapara në Statut.

Neni 11

Afatet e zgjedhjeve

Të gjitha organet duhet t'iu nënshtrohen zgjedhjeve të paktën çdo katër (4) vjet.

KAPITULLI IV
ORGANIZIMI DHE ORGANET

Neni 12

Organizimi i brendshëm

1. Organizimi i GUXO-së bëhet mbi bazën e parimit territorial. Në komunat e Republikës së Kosovës, GUXO mund të themelojë degë dhe nëndegë të subjektit.
2. Degët e GUXO jashtë vendit janë të organizuara po ashtu në bazë të parimit territorial.

Neni 13

Organet dhe komisionet

1. GUXO është organizim politik i qytetarëve të grupuar me vullnet të lirë në strukturat e saj.
2. Organet kryesore të GUXO janë:
 - 2.1 Kuvendi qendror;
 - 2.2 Këshilli i përgjithshëm me 103 anëtarë;
 - 2.3 Kryesia;
 - 2.4 Kryetari;
 - 2.5 Nënkryetari /ët;
 - 2.6 Sekretari i partisë.
3. GUXO themelon Komisionin për Çështje Zgjedhore, për të siguruar funksionimin efikas, konkurrencën e lirë, respektimin e statutit dhe rregullores për zgjedhjet e brendshme.
4. Komisionet në kuadër të GUXO janë:
 - 4.1 Komisioni për çështje zgjedhore;
 - 4.2 Komisioni vlerësues;
 - 4.3 Komisioni për administratë dhe financa;
 - 4.4 Komisioni statutar

Neni 14

Kuvendi

1. Kuvendi është organi më i lartë.
2. Kuvendi mund të jetë Kuvend zgjedhor dhe Kuvend pune.
3. Kuvendi i rregullt zgjedhor mbahet çdo katër vjet dhe në këtë Kuvend zgjidhen organet e subjektit.
4. Kuvendi i punës organizohet sipas nevojës ose së paku një herë ndërmjet dy kuvendeve zgjedhore.
5. Kuvendi, tre muaj para përfundimit të mandatit, shqyrton raportin e punës dhe atë financiar.
6. Kuvendin e thërret Kryetari i subjektit me pëlqim të kryesisë, duke respektuar afatet e caktuara..
7. Kuvendin e përbëjnë delegatët e zgjedhur në Kuvendet e degëve.
8. Kuvendi funksionon në parimin e delegimit të përfaqësimit përmes delegatëve të zgjedhur në çdo nivel.
9. Kuvendi zgjedh Kryetarin dhe Këshillin e Përgjithshëm.

Neni 15

Këshilli i Përgjithshëm

1. Këshilli i Përgjithshëm është organi më i lartë ekzekutiv, i cili vendos për modalitetin e pjesëmarrjes në procese zgjedhore.
2. Këshilli i Përgjithshëm merr qëndrime dhe vendime rreth çështjeve me interes nacional të rëndësisë së veçantë.

Neni 16

Kryesia

1. Anëtarë të kryesisë janë:
 - 1.1 Kryetari i GUXO;
 - 1.2 Tre nënkryetarët e subjektit;
 - 1.3 Sekretari i përgjithshëm;
 - 1.4 10 anëtarë të tjerë që propozohen nga Kryetari dhe miratohen në Kuvend.

Neni 17

Roli i Kryesisë

1. Kryesia:
 - 1.1 Merr vendime politike dhe vendime të tjera, në kompetencë të Kryesisë;

- 1.2 Kujdeset për zbatimin e vendimeve të Kuvendit, Këshillit të Përgjithshëm dhe vendimeve të tjera;
 - 1.3 Kujdeset për bashkërenditjen e punëve të degëve dhe të nëndegëve, përcjell realizimin e vendimeve të organeve, merr vendime konkrete lidhur me organizmin dhe funksionimin e tyre;
 - 1.4 Zgjedh anëtarët e komisioneve për çështje specifike;
 - 1.5 Nominon anëtarët e qeverisë;
 - 1.6 I propozon Kuvendit listën e kandidatëve për deputet në zgjedhje nacionale;
2. Punën e kryesisë e drejton Kryetari.
 3. Nënkryetarët ose Sekretari i Përgjithshëm e zëvendësojnë Kryetarin në rast të mungesës së tij ose sipas autorizimit.
 4. Kryesia e subjektit ka zëdhënësin, të cilin e emëron Kryetari.

Neni 18

Kryetari

1. Kryetari zgjidhet nga Kuvendi.
2. Kryetari përfaqëson dhe drejton subjektin në përputhje me statutin dhe programin, udhëheq punën e tij dhe organeve të tij, thërret dhe udhëheq mbledhjet e Kuvendit dhe të Kryesisë si dhe kujdeset për zbatimin e vendimeve të Kuvendit.
3. Për punën e tij, Kryetari i përgjigjet Kuvendit.

Neni 19

Nënkryetarët

GUXO ka nënkryetarët e partisë.

Neni 20

Sekretari i partisë

GUXO ka Sekretarin e Përgjithshëm, i cili propozohet nga Kryetari.

Neni 21

Komisioni statutar

1. Komisioni statutar mbikqyr zbatimin e statutit dhe vlerëson ecurinë e procesit të brendshëm zgjedhor;
2. Komisioni statutar është mekanizëm i përhershëm.
3. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë.

Neni 22

Forumet dhe mekanizma të tjerë organizativë të partisë

1. Në kuadër të GUXO, në nivel qendror dhe lokal, mund të formohen dhe veprojnë forumet dhe mekanizmat e tjerë si në vijim:
 - 1.1 Forumi i Gruas;
 - 1.2 Forumi i të Rinjve;
 - 1.3 Forumi i ekspertëve profesional;
2. Anëtarësimi në forumet e lartpërmendura është i lirë dhe gjithëpërfshirës. Secili anëtar i forumit ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet.
3. Funksionimi i forumeve përcaktohet me akte të veçanta.

KAPITULLI I VI
VEPRIMTARIA EKONOMIKE E SUBJEKTIT POLITIK

Neni 23

Financat

1. Burimet financiare përbëhen nga pagesa vullnetare e anëtarësisë, nga buxheti shtetëror sipas ligjit, nga ndihma e dhurata publike të parapara nga ligji për subjektet politike, si dhe nga çdo burim tjetër që autorizon ai.
2. Bilancet, ku përfshihen të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe buxheti vjetor i subjektit bëhen publike në faqen zyrtare në internet dhe në raportet periodike që dorëzohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
3. Financat e subjektit administrohen nga Zyrtari i Financave, i cili emërohet nga Kryetari. Zyrtari i Financave u raporton në baza periodike (6-mujore) Kryetarit dhe Kryesisë.

Neni 24

Shpërbërja

1. Me rastin e shpërbërjes së Partisë, së pari përmbushen detyrimet ndaj palëve të treta ndërsa për pjesën e mbetur, janë kompetente organet e partisë. Në rast se nuk ka dakordësim nga organet përkatëse, asetet financiare dhurohen për bamirësi.
2. Në rast të shpërndarjes, bashkimit ose shkrirjes së partisë në një parti tjetër, pala përgjegjëse së cilës i takon vendimi është Kuvendi i Partisë.

KAPITULLI I VII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 25

Miratimi i akteve zbatuese

Në zbatim të këtij Statuti, organet e subjektit nxjerrin rregulloren e punës që duhet zbatuar në kuvendet e rregullta dhe të jashtëzakonshme në përputhje me nenin 14 të rregullores 01/2013 për regjistrimin dhe veprimin e partive politike. Secili prej akteve të mësipërme si dhe statutet apo rregulloret e organizatave partnere nuk duhet të bien në kundërshtim me Statutin e GUXO-s.

Neni 26

Rishikimi i statutit

Statuti mund të rishikohet apo ndryshohet nga Kuvendi me shumicën e kualifikuar (2/3) të anëtarëve të tij.

Neni 27

Hyrja në fuqi

Ky Statut hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi Qendror.